

| Description |           |   |  |
|-------------|-----------|---|--|
| Date        | 7/17/2025 | Location  |  |
|             |           | Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar   |  |
|             |           | Salla 1   |  |
| Time        | Speaker   | Note  |  |
|             |           | Shënime të përmbledhura të seancës gjyqësore  |  |
| 1:11:24 PM  | Gjykata   | <p>Sot me datë 17.07.2025, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me trup gjykues të përbërë nga:</p> <p style="text-align: center;">K/seance: ERJON ÇELA</p> <p>Asistuar nga sekretare seance Erblina Dardha, çel seancën paraprake me dyer të mbyllura, për shqyrtimin e kërkesës penale me nr. 34/ 124 rregjistri themeltar, që i përket:</p> <p>Kërkues: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.</p> <p>Objekti: Kërkesë për dërgimin në gjyq të procedimit penal me nr.154 të vitit 2022.</p> <p>I pandehur: Arben Ahmetaj</p> <p>Akuzuar: Për kryerjen e veprave penale të “Shpërdorim detyre” e parashikuar nga nenin 248 të K. Penal.</p> <p>Kjo çështje penale regjistrohet audio, krahas dokumentimit me proces-verbal, konform nenit 115 të K.Pr.Penale dhe Vendimit Unifikues Nr.1, datë 27.04.2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.</p> <p>Verifikohet prezenca e palëve nga ku konstaton se:</p> <p>Është paraqitur Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, e përfaqësuar në gjykim nga prokurori e çështjes Elvin Gokaj</p> |  |
| 1:12:18 PM  | Prokurori | Elvin Gokaj i pranishëm.  |  |
| 1:12:21 PM  | Gjykata   | <p>Nuk është i pranishëm i pandehuri për të cilin gjykata ma marrë vendimin i deklarimit të mungesës së tij, në bazë të prokurës së lëshuar nga vet i pandehur është legjitimuar si mbrojtës në këtë proces për ta përfaqësuar atë avokatin Henrik Ligori, i cili është i pranishëm.</p>  |  |




|                   |           |   |
|-------------------|-----------|---|
| <u>1:12:39 PM</u> | Avokati   | Henrik Ligori i pranishëm.  |
| <u>1:12:41 PM</u> | Gjykata   | <p>Relatohet faza në të cilën ndodhet gjykimi.</p> <p>Në seancën e kaluar me kërkesë të avokatit Ligori për t'u njohur me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, dhe materialet që i janë bashkëlidhur asaj u kërkuar të shtyhet seanca gjyqësore.</p> <p>Prokurori nuk rezultoi ta ketë parashtruar apo relatuar të gjitha veprimet hetimore në plotësim të detyrave të lëna nga gjykata pikërisht për këtë arsye, të njihet mbrojtja dhe më pas do të procedohet në seancën e sotme.</p> <p>Pyetet avokati nëse është njohur me përmbajtjen e këtij fashikulli.</p>  |
| <u>1:13:26 PM</u> | Avokati   | Jam njohur me aktet shtesë në fashikullin e ri të cilat mi vuri në diospozicion sekretaria dhe jam njohur me to. Nga ana tjetër veç këtyre prokurori nëpërmjet Oficerit të Policisë Gjyqësor më ka njohur me një pjesë të deklarimeve të marra gjatë fazës së hetimeve paraprake. Në këtë situatë jam gati që të procedohet me vijimin e gjykimit.  |
| <u>1:14:12 PM</u> | Gjykata   | I jepet fjala prokurorit për të parashtruar para gjykatës në lidhje me sa gjykata ka urdhëruar për plotësimin e hetimeve.   |
| <u>1:14:20 PM</u> | Prokurori | <p>Paraqet kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq.</p> <p>Në përfundim i përmbahemi kërkesës dhe kërkojmë dërgimin e çështjes në gjyq të procedimit penale nr. 152/2022 në ngarkim të të pandehurit Arben Ahmetaj i akuzuar për veprën penale të "Shpërdorimi i detyrës" parashikuar nga neni 248 të K.Penal.</p> <p>Kërkoj të administrohet një kërkesë e cila është paraqitur nga përkthyesja e caktuar për përkthimin e akteve e cila ka qënë e pamundur të realizojë përkthimin e këtyre akteve.</p>  |
| <u>1:21:04 PM</u> | Gjykata   | I jepet fjala avokatit Henrik Ligori.   |
| <u>1:21:10 PM</u> | Avokati   | Pasi dëgjuam prokurorin pasi u njohëm me aktet e kryera rishtasi, natyrisht kemi disa pretendime dhe piknisja do të jetë vendimi me nr. regjistri themeltar 34/124 datë 10.12.2024 ku ju si gjyqtar proceduar duke i kthyer aktet prokurorit për të kryer disa veprime hetimore të domosdodhme si në drejtim në plotësisë së hetimeve ashtu edhe në drejtim të garantimit të të drejtave të mbrojtës në këtë proces. Në seancën e datës 02.07.2025 u informuam që në 30.06.2025 prokurori pati paraqitur një kërkesë për dërgimin në gjyq të çështjes të ashtuquajtur "Buka" sha në ngarkim të z. Arben Ahmetaj me të njëjtën akuzë sikundër edhe herën e parë. Që këtu |

ne duam të bëjmë një vërejtje. Nuk e kuptojmë se pse duhet të shkeleshin përsëri të drejtat e mbrojtjes, pasi procedura që normon neni 327 lidhur me njohjen e kateve nga mbrojtja në përfundim të hetimeve dhe për të çparaqitur pretendime është një çështje që mbehetet e hapur edhe kur çështja kthehet për hetime. Natyrisht prokuroria nuk e përmbushi këtë detyre dhe kjo është një shpenzim i panevojshëm e kohës, nëse do të ishte bërë kjo procedurë ne nuk do të ngrinin para jush ato gjëra që do të ngrinin në fillim por do ti kishim ezauruar në përfundim të hetimeve të kryera rishtazi dhe kjo do të ishte një gjë pozitive në raport me zgjatjen e procesit dhe zgjidhjen e tij brenda një afati të arsyeshëm. Ne pasi u njohëm me aktet e kryera rishtazi nga ana e prokurorisë së posaçme me keqardhje konstatojmë se pjesa thelbësore e detyrave thelbësore të caktuara nga kjo gjykatë nuk janë respektuar dhe ligjshëmira e hetimeve është cenuar. Kështu që jemi të detyruar të parashtrijmë para jush disa çështje të procedurës dhe lidhen me urdhërimet e gjykatës për të kryer këto hetime plotësuese.

Gjykata e Posaçme pranoi pretendimin e mbrojtjes për bashkimin e dy procedimeve në një procedim të vetëm, me logjikën se e vërteta realizohet më mirë kur faktet hetohen në mënyrë intergrale, kjo shmang nga një rrezik tjetër, elementët faktual të fragmentarizuar, dhe gjykata të mos jetë në gjendje që të kuptojë se çfarë ka ndodhur në të vërtetë në këtë histori privatizimi të aksioneve shtetërore të Buka sha. Gjykata në vendimin e saj, theksoj "... se ndarja e procedimit penal i dëmton interesat e hetimit jo vetëm përsa i përket vërtetimit të fakteve, por edhe përsa i përket kualifikimit të drejtë dhe të plotë të akuzës." Këtë e thotë gjykata në mënyrë të shprehur në vendimin e saj. Çfarë ka ndodhur? Me datë 27.01.2025 prokurori ka marrë vendim për bashkimin e procedimit në zbatim të urdhërimit të gjykatës, mandjes pasi janë kryer disa nga aktet që thamë, pikërisht në datë 30.06.2025, ditën që ka formuluar kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq prokuroria ka vendosur ndarjen e procedimit penal mbi bazën e logjikës që oficeri i policisë gjyqësore ka sygjerruar që hetimet të ndahen dhe të vazhdojnë në një procedim më vete. Me këtë vendimmarrje ne u kthyem në pikën e nsijes, problemi është se këtu del që sygjerimi i hetuesit paska më shumë fuqi sesa vendimi i gjykatës që ka urdhëruar bashkimin e këtyre procedimeve. Ne këtu para jush jemi sepse Arben Ahmetaj nuk ka zbatuar një vendim gjyqësor. Dhe ndodhemi në një situatë absurde kur vet prokuroria nuk zbaton vendimin e gjykatës. Me çfarë të drejte do të kërkojë që Arben Ahmetaj të respektojë vendimin e gjykatës kur vet nuk e respekton. Ne nuk na duket që kjo është një zgjidhje e drejtë sepse duket sikur mbetet në përsëri në të njëjtën pikë.

Nga kjo kuptojmë edhe një koncept tjetër. Prokurorisë nuk i interesojnë faktet në tërësinë e tyre. Nga leximi i deklarimeve duket qartë që lidhur me procedurat e ankandit që janë persona të tjerë, z. Ahmetaj nuk ka asnjë pikë takimi në lidhje me atë procedurë. Prokuroria targeton z. Ahmetaj dhe i intereson të shkojë patjetër në gjyq, për të tjerët të shtyhet sa të mundet dhe nuk dihet si do u veje filli atyre. Duke hetuar faktet në tërësinë e tyre del më qartë e vërteta. Kuptohet fare qartë roli i gjithsecilit. Ne nuk kemi ftikë që z. Ahmetaj mund të dalë që ka bashkëpunuar me ato që ka ngritur akuza. Nëse ka bashkëpunuar të përgjigjet, ama të hetohet në mënyrë integrale për të kuptuar se çfarë ka ndodhur vërtetë në këtë histori. Gjykata e kuptoj këtë gjë, vendosi që procedimet të bashkohen dhe prokuroria vjen përsëri me procedime të ndara para jush. Së dyti një pjesë e akuzës ndaj z. Ahmetaj lidhet me pretendimin e prokurorisë se ai nuk ka marrë masa për të ekzekutuar një vendim gjyqësor, vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. 5300, datë 22.10.2015, lënë në fuqi me vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit nr.4959, datë 30.11.2017, i cili urdhëronte anulimin e urdhërit nr. 382, datë 24.07.2014 të ministrit të MZHETS "Për privatizimin e paketës shtetërore të aksioneve të shoqërisë "Buka" Sh.a.". Në seancë ne pretenduam se këto vendime tashmë janë prishur janë inekzistene dhe çështja është kthyer për rigjykim në shkallën e parë, falë vendimit të kolegjit administrativ të Gjykatës së Lartë nr. 285, datë 04.07.2024. Kjo Gjykatë la për detyrë që vendim të administrohet nga prokuroria dhe të përfshihej në fashikullin e hetimeve paraprake, nga aktet që mora ky vendim nuk është në dosje. Problemi është jo thjesht prokuroria sillet sikur ky vendim nuk ekziston, problemi është të reflektohet në bazë të këtij vendimi për akuzat e ngritura. Po të lexosh kërkesën e re të paraqitur nga prokuroria për gjykimin e çështjes, u referohet dy vendimeve dhe nuk e zë në gojë fare vendimit të kolegjit administrativ të Gjykatës së Lartë, duket sikur ky vendim është inekzistent dhe këty dy vendime janë në fuqi dhe prodhojnë efekte juridike, ndërkohë që këto vendime janë prishur dhe ky është një fakt historik, i provuar. Së treti: Gjykata la si detyrë që të analizoheshin të dhënat që buronin nga regjistrat e takimeve të sekuestruara në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ku z. Ahmetaj ishte titullar i saj, me qëllimin për të nxjerrë konkluzione të mundshme të këtij persona të tjerë (faqe 94, par. 4). Asnjë analizë e regjistrimeve nuk është kryer por ne e dimë pse nuk është bërë: kjo nuk është bërë sepse nuk buron asnjë e element indiciare që të implikojë veprime të paligjshme të kryera nga z. Ahmetaj. Z. Ahmetaj nuk ka takuar njeri, as Lirim Fejzollari dhe as persona të tjerë. Analiza e tyre dhe të paktën hartimi i raportit mbi këqyrjen e tyre ishte detyrë e lënë nga gjykata, kjo duhet të respektohet. Nuk është respektuar. Së

katërti: Gjykata la si detyrë të kryhej një analizë e hollësishme e rezultateve të përgjimeve telefonike të urdhëruara në kuadër të këtij hetimi këtë e thot në faqe 94 pg. 3, detyrë që nuk është kryer, sepse përsëri nëse shqyrtohen këto, ne si mbrojtje i kemi parë, nuk ka asnjë e dhënë indiciare në mbështetje të akuzës së ngritur nga prokuroria ndaj z. Ahmetaj. E pesta: Në aktet shitesë të depozituara në Gjykatë, në këto që ne morëm nga ana e sekretarisë, përsëri nuk janë përfshirë deklaratimet e personave të pyetur gjatë hetimeve paraprake. Na shkon në mendje synohet që gjykata të mbahet jashtë vëmendjes dhe pasojave që mund të krijojë në bindjen e saj këto deklaratime të cilat mbahen jashtë sferës. Gjykata tha këto deklaratime duhet të njihet mbrojtja, por para se të njihet mbrojtja, duhet të njihet gjykata. Këto deklaratime duhet të jenë pjesë e fashikullit të gjykatës. Ne nuk e dimë sa deklaratime janë marrë në hetimeve paraprake, ne prezumojmë që prokuroria ka qënë juajale dhe na i ka dhënë deklaratimet. Por konstatohet që z. Endrit Duçka, sekretari i përgjithshëm i Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, personi i cili ka ndjelkur nga afër të gjithë procedurën e ankandit personazhi kryesor për shkak të komunikimeve të vazhdueshme me Lirim Fezollari, të dokumentuara edhe nga jetimet e kryera nga prokuroria, deklaratimet e tij nuk i kemi këtu. Ne do të donim ti kishim dhe ato, të shkimin çfarë pretendon apo çfarë faktesh sjell në lidhje me këtë procedurë kaq të kontestuar. Në këtë aspekt të viheshin në dispozicion të gjitha deklaratimet e marra gjatë hetimeve, detyrim që Prokuroria e Posaçme e përmbushi vetëm pjesërisht. Ky akt mungon. Pastaj aktet të tjera që janë kryer në përmbushje të urdhërimit të gjykatës dhe janë përfshirë në fashikull duke përfshirë edhe hetimet pasurore lidhur me kompatitë e z. Fezollari natyrisht del qartë edhe nga relacioni që nuk kanë asnjë lidhje dhe prej tyre nuk buron asnjë eklement prove që mundet të ndikojë në pozitën e të mbrojturit prej meje në proces, ato mund ta shfajësojnë pasi edhe hetimet e kryera rishtasi nukl provojnë që z. Ahmetaj në një mënyrë apo tjetër të ketë qënë i lidhur me z. Fezollari apo persona të tjerë i përfshirë për shkak të detures dhe ligjit në ankandin e kryer në qershor të vitit 2014 e në vijim, deri sa u arrit në lidhjen e kontratës. Këto ishin ato që ne konstatuam dhe në referencë të këtyre mangësive ne kërkojmë që ligji të rivendoset dhe i kërkojmë gjykatës që Prokuroria e Posaçme të urdhërohet dhe të zbatojë vendimin e Gjykatës në mënyrë integrale, sepse ndryshe ligji bëhet qesharak. Tani del që përsëeti çështja të mbahet pasi kemi për të marrë një letërporosi nga Austria dhe kjo letërporosi nuk është përkthyer pasi nuk ka pasur mundësi përkthyesja. Dakord, të presim, nuk e kuptoj prokuroria çfarë ngutje ka, le të presim nuk kemi asnjë ngutje, personi është në arrati, asnjë afat nuk ka. Pse të nxitohemi dhe të mbajmë çështjen e ndarë. Kjo nuk është e ndershme që përsëri aktet të veçohen. Nëse letërporosia e ardhur



nga autoritetet Austriake dalin të dhëna në ngarkim të z. Ahmetaj, të vijnë. Ne jemi gati të përballemi me to. Po përsëri këto fakte ne na mbahen të pamjohura. Kështu dëmtohet e drejta e mbrojtës. Nëse do të kthehemi te thelbi i akuzës. E kuptoj që ky xhirim i akteve nga gjykata në prokurori dhe anasjelltas nuk sjell asnjë dobi, por edhe në parashtrimin e parë që ne kërkuam të referohet si pjesë integrale e këtyre që themi sot. Mund të themi se hetimet shitesë nuk sollën asnjë gjë të re në ngarkim të akuzave ndaj Ahmetaj, është një fakt i paqënë, akuzat nuk thotë cilin ligj ka shkelur z. Ahmetaj, por thuhet se ka penguar ekzekutimin e vendimeve të gjykatës. Thuhet që nuk ka vlerësuar sipas vlerës së tregut aksionet e privatëve të shoqërisë Buka sha. Arben Ahmetaj pikërisht këtë ka bërë, ka vlerësuar asetet shtetërore e "Buka" Sh.a., me vlerën e çmimit të tregut. Këtë e thonë në deklaratimet e tyre shtetasit z. Emil Nova dhe znj. Silvana Gjikhima, fakti që shteti ka futur 32000 m tokë dhe privati 8000 m tokë nuk ka sesi që aksionet, pjesa e privatit të bëhet më e madhe se e shtetit, me anë të një akt ekspertimi qesharak të bërë nga privati. Prokurori i referohet atij ekspertimi duke mos parë akt ekspertiminë bërë nga shteti. Është fakt i provuar, se vlera nominale e aksioneve të ish-pronarëve (natyrisht, edhe të shtetit), referuar çmimeve të tregut, është trefishuar por është absurde të thuash që vlera e asteve të privatit të vlerësohet me shumë sesa vlera e aseteve të shtetit. Në këtë rast z. Ahmetaj do të kishte shpërdoruar detyrën. Lidhur me pasojën, përsëri prokuroria këmbëngul që janë dëmtuar interesat e pronarit dhe të shtetit. Interesat e pronarit dhe të shtetit janë të kundërta nëse favorizohet shteti do dëmtohet privati dhe nëse favorizohet privati do të dëmtohet shteti. Ne mendojmë akuzat është arbitrate e pa mbështetur në prova dhe në ligj. ka një lloj tendenc për ta targetuar z. Ahmetaj dhe për ta dërguar në gjyq.

Ne kërkojmë përfundimisht që:

Riurdhërimin e prokurorit që të ekzekutojë vendimin e gjykatës dhe t'i bashkojë procedimet e ndara dhe, në interes të provueshmërisë së fakteve dhe të së vërtetës, t'i hetojë ato bashkërisht;

2- Të kryhen edhe detyrat e tjera të urdhëruara nga gjykata, të cilat i përmendëm në hollësi dhe që nuk janë kryer;

3- Gjykata ta ftojë prokurorin që të saktësojë akuzën në tri aspekte:

- (i) të tregojë ligjin, nenin, paragrafin dhe shkronjën përkatëse të tij, që ka shkelur i pandehuri Ahmetaj;
- (ii) të identifikojë viktimën në proces dhe të qartësojë argumentin pse, në këtë rast, privati dhe shteti janë njëkohësisht viktimat, duke saktësuar dëmin e matshëm për secilën palë të dëmtuar;

|                   |           |   |
|-------------------|-----------|---|
|                   |           | <p>(iii) të qartësojë për gjykatën dhe të pandehurin, që nëse akuza e ka seriozisht se i pandehuri ka penguar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, pse nuk akuzohet sipas dispozitës që penalizon posaçërisht këtë sjellje (neni 320 i KP - pengim në ekzekutimin e vendimeve të gjykatës);</p> <p>5- Mbrojtjes t'i vihen në dispozicion kopje të të gjitha deklaramëve të personave të pyetur, duke përfshirë edhe deklaramet e Endrit Duçkës. Këto deklaramet duhet të përfshihen edhe në fashikullin e Gjykatës.</p> <p>Si alternativë më e arsyeshme, nëse Gjykata vlerëson se fakti që i kontestohet të pandehurit Ahmetaj nuk ekziston, sikundër ka parashtruar mbrojtja në pretendimet e saj, është krejt joefektive që kjo çështje të vazhdojë, ndaj duhet të vendoset pushimi i saj.</p> <p>Parashtrimin e kemi me shkrim.</p> |
| <u>1:43:02 PM</u> | Gjykata   | Avokati megjithëse i relatoj në mënyrë të detajuar i parashtrroj pretendimet e tij, i depoziton me shkrim me 4 fletë.   |
| <u>1:43:09 PM</u> | Gjykata   | I jepet fjala prokurorit.   |
| <u>1:43:29 PM</u> | Prokurori | <p>Do ti marim me radhë pretendimet e paraqitura nga ana e mbrojtjes.</p> <p>Fillimisht vendimi nr. 285 datë 04.07.2024 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, është administruar në gjykatë dhe ka qënë e panevojshme të paraqitet përsëri pasi kjo gjykatë është njoh me me këtë vendim.</p> <p>Përsa i përket deklaramëve ka firmos një procesverbal me të cilin ka marrë nga oficeri i policisë gjyqësore deklaramet. Procesverbali është firmos edhe nga ana e mbrojtjesit. Nuk ka ngrit pretendime për deklaramet shtesë e as për pretendime për ato që nuk i janë dhënë nga OPGJ. Unë do e shoh procesverbalin nëse i janë vënë në dispozicion?</p>  |
| <u>1:44:25 PM</u> | Gjykata   | Këto procesverbale që i keni vënë në dispozicion avokatit dhe i tregoj në seancë gjyqësore a janë pjesë e volumeve hetimore?  |
| <u>1:44:40 PM</u> | Prokurori | Kanë qënë objekt i procedimit të ndarë. Unë këta persona i kam thirr për ti pyet si dëshmitar.  |
| <u>1:44:52 PM</u> | Gjykata   | <p>Ja keni dhënë në avokatit për tu njohur me përmbajtjen e tyre. Ja keni dhënë në funksion të këtij procesi, jo të procesit të ndarë?</p> <p>Rrjedhimisht lind pyetja: a janë këto akte që thot avokati Ligori?</p>  |

|                   |                  |   |
|-------------------|------------------|---|
| <p>1:45:08 PM</p> | <p>Prokurori</p> | <p>Në momentin që ne i kemi drejtuar kërkesën gjykatës dhe praktika e gjykatës, nuk administrohen deklaratimet e personave që pyeten si dëshmitar. Nëse ka një rregull të ri ne i administrojmë pa asnjë problem. Në gjykatë nuk i kemi paraqitur. Ka qënë fashikulli i sjellë para 1 viti.</p> <p>Përsa i përket pretendimit të avokatit që prokurori nuk ka zbatuar vendimin e gjykatës nuk qëndron. Pasi ne jemi njohur me vendimin kemi bashkuar procedimin. Duke pas parasysh që ka shumë hetime dhe prokurori nuk mund të kushtëzohet pa ba një hetim shterrues për të gjithë çka është duke hetu. Këto akte të cilat i vuna në dijeni gjykatës lind pyetja ku do ti çoj këto akte kur të vinë pas një periudhë kohe te procedimi i ndarë. Janë akte që janë prodhu nga hetimet e procedimit 154/1 i vitit 2023, ku po hetohen Lirim Fezollari, Endri Buçka për patrim parash, për komunikim me njëri tjetrin. E shumë e shumë veprime të tjera hetimore. Në mom,entin që nuk është rëndu pozita e të pandehurit Arben Ahmetaj ne nuk kemi pas nevojë për të vu akte të tjerë shtesë. Nëse do të ishte në bashkëpunim ne do të paraqitshme një akuzë për bashkëpunim me persona të tjerë që po hetohen. Ne nuk i kemi rëndu pozitën e të pandehurit. Vepra penale për të cilën është akuzuar nuk është në bashkëpunim. Prokurorin nuk e kushtëzon nëse dalin rrethana të reja për akuzë të re pastrim parash nëse mund të vijnë të përgjigje nga autoritetet austriake që mund të kenë transferta ndërmjet Lirim Fezullari dhe të pandehurin Arben Ahmetaj, nuk e pengon K.Pr.Penale për të ngrit akuzë të re. Deri në këtë fazë nuk kemi të dhanë, që ka komunikim ose ka pas transferta lekësh me Lirim Fezollari apo Endri Duçka. Jemi drejtu me çka po hetohet për shpërdorim detyre, për faktin që ka zbatu një urdhër të ministrit. Nuk mund ta provoj që ka bashkëpunim për zbatim të një urdhëri të ministrit. Për ato që ka lënë gjykata, për të verifiku pasuritë e këtyre personave ashtu si u shpreha ka një procedim për pastrim para për Arben Ahmetaj dhe nuk është e ligjikshme për të bërë hetim paralel. Për faktin që personat të cilat unë po hetoj nuk m ë lidhen në asnjë moment me transferta lekësh me të pandehurin Arben Ahmetaj. Kam marrë informacion nga zyra dhe thot po e hetojmë për pastrim parash. Personat që unë po hetoj unë nuk kanë asnjë transfertë me apo pasuri të cilën e kam të dyshuar që ka ardh nga komunikimi apo veprimi me Arben Ahmetaj, jam në moment procedural që nuk kam element bashkëpunimi. Kjo ka qënë arsyeja çpse unë e mbaj të veçuar, të gjuitha këto akte qo do të vijnë, dyshohet që Lirim Fezullahu ka transferu shuma lekësh në austri, kujt ja ka dërguar. Arben Ahmetaj, x, y?! Atëhet kur të vijnë përgjigjet. Për këtë u kriju procedimi penal 154/1 që të jetë për administrim aktesh. Unë mund të vi për vendim pushim apo mund të vi me vendim për dërgimin në gjyq për të gjithë personat. Duke pas parasysh veprën penale për</p> |
|-------------------|------------------|---|

|                          |                |   |
|--------------------------|----------------|---|
|                          |                | <p>të cilën dyshohet. Për veprën penale kemi pas parasysh edhe afatet e parashkrimit të veprës penale. urdhëri nr. 303 i cili ne pretendojmë që është dhënë në kundërshtim me ligji ka dalë me datë 24.07.2014, nëse ne nuk do të kishim akuzë para kësaj date ajo akuzë do të parashkruhej. Duke qënë që prokurori krijoj bindjen për veprën penale atëherë ngriti akuzë. Për këtë fazë që jemi kemi priva që Arben Ahmetaj ka konsumuar element të veprës penale. edhe mbrojtësi i të pandehurit e tha që nuk ka asnjë lidhje ndërmjet Lirim Fezollahi që po hetohet në procedimin në vete.</p> <p>Nga ana e prokurorit nuk është përcaktuar se kush është shteti apo privati. Ne pretendojmë që është dëmtuar familja Myderizi, ka pas një vendim të Gjykatës Kushtetuese, ku ai duhet të kompesohet sipas vlerës së çmimit të tregut dhe jo sipas një vendimi të vitit 1994 duke i sjellë pasojë kësaj familje. Pra unë edhe te kërkesa për dërgimin në gjyq e kam fut si palë të dëmtuar në procesin penal, këtë mund ta shihni edhe në kërkesë për gjykim, e kam fut si palë të dëmtume në procesin penal, familjen Myderizi.</p> |
| <p><u>1:53:30 PM</u></p> | <p>Gjykata</p> | <p>Nuk është identifikuar viktimë tek kërkesa e parë?</p> <p>Nuk ka viktimë. Kërkesa nuk ka të identifikuar viktimë.</p> <p>I jepet fjala Av. Ligori.</p> <p>Procesverbalet e vëna në dispozicion nga prokurori janë të procedimit të ndarë apo jo?</p> <p>Për ju janë thelbësore këto procesverbale për tu administruar në gjykim?</p>   |
| <p><u>1:53:51 PM</u></p> | <p>Avokati</p> | <p>Janë shumë thelbësore.</p> <p>Prokurori tha që mbrojtësi i ka nënshkruar që i ka marrë, dhe tani thot që nuk i ka marrë. Unë nuk kam marë në inventar të akteve, unë i kam marë në hollin e gjykatës. Unë firmosa pa një inventar. Kur i pashë shoh që mungon deklarimi i Endrit Duçka.</p>  |
| <p><u>1:54:33 PM</u></p> | <p>Gjykata</p> | <p>Në lidhje me pretendimin tjetër të prokurorit që duhet të thirret në cilësinë e trashëgimtarit të viktimës familjarët e familjes Myderizi.</p> <p>Kush është ky person, cilët janë këta viktima. Identifikohet vetëm familja Myderizi? Cilët janë këta viktima dhe i qëndroni ju kësaj kërkesë që duhet të thirret kjo palë në proces.</p> <p>Në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq nuk është identifikuar.</p> <p>I jepet fjala prokurori.</p>  |



|                   |                             |  |
|-------------------|-----------------------------|--|
| <u>1:55:29 PM</u> | Prokurori                   | <p>Ardjan Myderizi është ai që ka vu në lëvizje që këtë proces penal. Kasem Sali Myderizi është babai i tij dhe ka vdekur. Ky ka qënë pronar i ligjshëm i pronës tek fabrika Buka. Si trashëgimtar ligjor ka vu në lëvizje prokurorinë. Edhe kërkesën për dërgimin në gjyq ja kemi njoftuar. Me shkresë përcjellëse i kemi dërgu kërkesën për dërgimin në gjyq.</p> <p>Ky është viktimë dhe duhet të thirret</p>   |
| <u>1:56:29 PM</u> | Gjykata                     | I jepet fjala avokatit Ligori.   |
| <u>1:56:32 PM</u> | Avokati<br>Henrik<br>Ligori | <p>Qëndrimi im është ky që në këtë proces nuk është viktimë as privati e as shteti, kjo është një pseudo akuzë. Unë ju referova në mënyrë të shprehur asaj që ka thënë prokurori në kërkesën për gjyq. Tani ngrihet prokurori e thot viktimë është shteti, në faqen 27 kush e ka thënë tek kërkesa për gjykim e vjetra, në kërkesën e re në faqen 30 kush e ka thënë.</p> <p>Këtë po them unë duhet ndarë. Kush është dëmtuar shteti apo po privat? Këto i ka shkruar vet.</p>   |
| <u>1:58:02 PM</u> | Prokurori                   | Përsa i përket.  |
| <u>1:58:09 PM</u> | Avokati                     | Nuk janë thirrur, nuk ka kërkesë as formalisht sepse përndryshe do të ishin thirr nga gjykata.   |
| <u>1:58:28 PM</u> | Prokurori                   | <p>Përsa i përket pretendimeve të mbrojtës mendoj që edhe tek parashtimet referojnë në akteve ekspertimi të paraqitur si provë për të provuar damin ekonomik që i asht sjellë familjes Myderizi. Nga Kasem dhe Sali Myderizi të përfaqësuar me prokurorë, në bazë të kallxuesit janë administruar ky akt ekspertimi për të cilin ne kemi vu 6698666 leke duke referu edhe aksionet që i janë e mohurara kësaj familje.</p> <p>Unë në kërkesën për gjyq e kam kërkuar si person të dëmtuar që të paraqitet në proces penal.</p>                               |
| <u>1:59:25 PM</u> | Gjykata                     | <p>Pasi keni nënshkruar kërkesën, është vendosur një paragraf ku thoni në mbështetje të nenit 58/1/h të K.Pr.Penale trashëgimtarët e familjes Myderizi kanë të drejtë të kërkojnë dëmin e shkaktuar por nuk thua të thirren në cilësinë e veprës penale. thjesht keni bërë një referencë në nenin 58/1/h, por pa identifikuar ndonjë individ me emër mbiemër, gjeneralitete të sakta që gjykata të procedonte me identifikimin e tij njoftimin për të marrë pjesë në këtë gjykim.</p> <p>Ju i qëndroni kësaj kërkesë për ta thirrur këtë palë në gjykim?</p> |

|            |           |   |
|------------|-----------|---|
| 2:00:26 PM | Prokurori | Adresën e personin për të cilin kam kërku të marrë pjesë në proces penale është në shkresat që i kam nisur për komunikim.   |
| 2:00:43 PM | Gjykata   | I qëndroni kësaj kërkesë?   |
| 2:00:45 PM | Prokurori | Po  |
| 2:00:48 PM | Gjykata   | I jepet fjala avokatit.   |
| 2:00:50 PM | Avokati   | <p>Këtu bëhet fjalë për vlerësimin e aksioneve të një kompanie, ku asetet e palëve që kanë hyrë në shoqëri janë të kapitalizuara, nuk mundet që ti të vlerësosh aksionet e privatit dhe të lësh pa privatizuar të shtetit. Prokurori thot ka dëmtuar privatin pasi i ka vlerësuar me çmimin e vitit 1994, nga e gjen këtë, nuk është e vërtetë, janë vlerësuar me aktin e tregut.</p> <p>Nëse prokurori mban qëndrim që viktimë është privati të modifikojë akuzën. Nuk kemi problem ne në lidhje me këtë.</p> <p>Së dyti, lidhur me pretendimin tonë: në lidhje me zbatimin e ligjit. Prokurori thot ne do të bëjmë hetime në austri, nuk është përkthyesi. Le të bëhet hetime, çështja nuk duhet ndarë, çfarë ngutje ka prokurori. Të kryhen hetime në austri, të meren akte. Ku i dihet atje mund të dalë një xhirollogari, do të nisë hetim të ri? Unë nuk e kuptoj këtë llogjikë. Të kryhen hetime dhe të konkludiojë me një hetim. Të kemi një kuadër integral të çështjes. paska shumë komunikime mes Duçka dhe ferzollari, në këtë procedurë, pse ja mban larg gjykatës. Dhe pastaj ngritesh këtu dhe pretendon që z. Ahmetaj njihet shumë mirë me z. Fezollari, pasi paska në vitin 2019 dy biseda, 5 vite pas asaj. Nuk e kuptoj këtë. Unë them që ndarja bëhet qëllimisht, së pari të bëhet target Arben Ahmetaj që ti japim një precedent dhe së dyti faktet në tërësinë e tyre dëmtohen. Gjykata të mos arrijë të kuptojë në këtë proces. Nga gjithë deklaratimet del që ka qënë indiferent. Ai nuk e ka cuar përfaqësuesin e ministrisë së tij.</p> |
| 2:04:21 PM | Gjykata   | Pa hyrë tek pjesa përmbyllëse në lidhje me akuzën.  |
| 2:04:30 PM | Avokati   | Nuk mund të copëzohet hetimi.   |
| 2:04:35 PM | Gjykata   | Pyetja është e qartë të thirret apo të mos thirret viktimia?  |
| 2:04:58 PM | Avokati   | Nuk kemi problem me të. Akuza duhet të jetë koherente, duhet të mbajë qëndrim kush është viktimë.   |
| 2:05:08 PM | Gjykata   | Do ja japim fjalën gjykatë.   |



|            |           |  |
|------------|-----------|--|
| 2:05:20 PM | Avokati   | Ne themi nuk ka viktimë. Është e vërtetë që në atë procedim që ka verifikuar prokurori z. Ahmetaj ka një mal me akuza. Pse duhet të mbajë edhe një gjë që nuk i takon fare. Kjo nuk ka shumë rëndësi, nëse pretendon që është dëmtuar privati të thirret privati, nëse pretendon që është dëmtuar shteti të thirret avokati i shtetit. Për ne ka rëndësi që hetimi të jetë tërësor, integral dhe të zbatohet vendimi i gjykatës i datës 10.12.2024.  |
| 2:06:00 PM | Gjykata   | I jepet fjala prokurorit.  |
| 2:06:04 PM | Prokurori | <p>Me çdo kush kërkon që të diktohen veprimet hetimore. Tani urdhëri 324 i ministrit Ahmetaj më lidhet dhe përkon me hetimin për transferta të parave me Lirim Fejzollari?! Nuk më lidhet. Atëherë pse duhet të pres përgjigjet për të ngrit një akuzë të re kur unë nuk pretendoj? Përsa i përket pjesës, në asnjë rast nuk kam pretendu që i kam ardh dam interesave të shtetit por të shtetasve. Mund të jetë një lapsus. Edhe tek kërkesa për gjykim, përfundimi i hetimeve nga unë asht hetu për damin që i asht shkaktu familjes Myderizi.</p> <p>Të thirret viktima.</p>  |
| 2:08:00 PM | Gjykata   | <p>Duke marrë shkas nga debati i gjyqësor që zhvilluat palët në seancën e sotme fillimisht në lidhje me kërkesën që ju paraqit nga avokati Henrik Ligori për të bërë pjesë të dosjes gjyqësore të seancës paraprake dhe procesverbalet të cilat atij i janë vënë në dispozicion nga organi i akuzës dhe që prokurori deklaroi që nuk janë pjesë e provave bashkëlidhur kërkesës objekt gjykimi, gjykata lë detyrë prokurorin që të depozitojë në sekretarinë e gjykatës një kopje të njëhësuar me origjinalin të të njëjtave akte që i ke vendosur në dispozicion të avokatin në mënyrë që gjykata ti verifikojë dhe të vlerësojë nëse ato janë të dobishme dhe kanë vlerë në lidhje me çështjen objekt gjykimi apo jo.</p> <p>Në lidhje me kërkesën për thirrjen në cilësinë e trashëgimtarit të viktimës së shtetasit Adrian Myderizi, gjykata konstatoj në lidhje me paraqitjen e një kërkimi të tillë vetëm në ditën e sotme, kjo nga debati gjyqësor që patën palët. Duke ju referuar kërkesën objekt gjykimi nuk identifikohet me gjeneralitetet të sakta dhe cilësi të tillë thirrje një palë tjetër, duke mbajtur në konsideratë rrethanat e faktit si dhe përcaktimet e ligjit procedural penal, nenit 228/a pika 1 shkronja c i cili përcakton pasojat e pavlefshmëri absolute në lidhje me thirrjen në gjykim të të pandehurit apo viktimës, duke qënë se konstatohet nga gjykata që thirrja apo mosthirrja e viktimës në seancë paraprake ka pasojat ligjore nga ligji me pavlefshmëri absolute të aktit, duke marrë në konsideratë dhe vlerësuar rrethanat faktike që prokurori atribuon akuzën të pandehurit Arben Ahmetaj gjykata bazuar në nenin 58 pika 1 shkronja h të K.Pr.Penale vendosi</p> |

|                   |           |  |
|-------------------|-----------|--|
|                   |           | ta thërrasi këtë shtetas me këtë cilësi për seancën gjyqësore të radhës.<br><br>Prokurori në sekretari duhet të depozitojë të dhënat e këtij shtetasi në mënyrë që gjykata të procedojë me njoftimin e tij me fletëthirrje.          |
| <u>2:10:59 PM</u> | Gjykata   | Në këto kushte seanca ndërpritet këtu.   |
| <u>2:11:12 PM</u> | prokurori | Në faqen 36 të fashikullit, janë të dhënat e personit që kërkojmë të thirret.  |
| <u>2:11:43 PM</u> | Gjykata   | Detyrë lihet të depozitoni në një kohë sa më të shkurtër një kopje të akteve.<br><br>Në këto kushte seanca gjyqësore ndërpritet këtu.<br><br>Pyeten palët nëse kanë dakordësi që seanca të caktohet për në datë 24.07.2025 ora 11.00 |
| <u>2:12:05 PM</u> | Avokati   | A është e mundur të kryhet njoftimi, është kohë e shkurtër. Kam në orën 11 një gjyq. nëse është e mundur një orë të mëvonshme.   |
| <u>2:12:38 PM</u> | Gjykata   | Pyeten palët për në datë 25 ora 14.00  |
| <u>2:12:45 PM</u> | Prokurori | Dakord   |
| <u>2:12:45 PM</u> | Avokati   | Dakord   |
| <u>2:12:46 PM</u> | Gjykata   | Konfirmohet seanca gjyqësore për në datë 25.07.2025 ora 14.00.<br>Palët prezent morën dijëni.<br>Të njoftohet trashëgimtari i viktimës.<br>Të depozitohen një kopje e akteve përkatëse.  |
| <u>2:13:23 PM</u> | Gjykata   | Seanca deklarohet e mbyllur.   |

Tiranë më 17.07.2025 (sistemi i regjistrimit në audio mbyllet në ora 14.14)

**SEKRETARE**  
**ERBLINA DARDHA**



